



**Të ndihmojmë dhe fuqizojmë  
njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme  
të formojnë dhe përcaktojnë jetët e  
tyre me dinjitet dhe pavarësi.**

"Si institucion i arsimit të lartë privat, Shkolla e Lartë "Nehemiah Gateway" është e përkushtuar që të ofrojë cilësinë më të lartë në arsim për studentët tanë. Kjo u mundëson atyre të bëhen profesionistë të suksesshëm në fushat e tyre të zgjedhura dhe të ndikojnë pozitivisht në komunitetin e tyre".

"Ne jemi të bindur, që nëpërmjet një arsimi cilësor, studentët tanë do të pajisen me mjetet e nevojshme për të filluar dhe për të qenë pjesë e zhvillimit social-ekonomik".

Shkolla e Lartë "Nehemiah Gateway"

**Kursi - Komunikimi dhe  
të shkruarit në vendin e punës**

Kohëzgjatja: 10 orë (dy ditë në fundjavë)

Vendi:

Kampusi Nehemia Gateway Albania, Buçimas

Pagesa:  
4.000 Lekë

Dokumenti në përfundim të kursit:  
Certifikatë

**Për regjistrime dhe informacion kontaktoni:**

**Dorian Leka**


Email: [dorian.leka@ng.university](mailto:dorian.leka@ng.university)

Tel: 069 270 5065

Instruktori i kursit:  
**Dr. Nada Kallciu**



## **Marketing në Turizëm Mikpritja dhe trashëgimia kulturore**





## Përshkrimi i kursit

Qëllimi kryesor i këtij kursi është të ofrojë dije, të ndërtojë shprehi praktike dhe të sigurojë udhëzime konkrete në ndërtimin dhe realizimin e marketimit në turizëm. Si të ndërtojmë një strategji për marketimin e produktit turistik? Media dhe neë media. Kujt i drejtoshemi? Pse i drejtoshemi? Qëllimi për të cilin duam të komunikojmë? Cilët janë klientët e mundshëm dhe si duhet të ndërveprojmë me ta? Cfarë kërkojnë klientët? Cilat janë strukturat në nivel kombëtar dhe lokal që mund të ndihmojnë në dukshmérinë e ofertave turistike?

Gjatë kursit pjesëmarrësit do të pajisen me dije teorike dhe shkathtësi praktike për të qenë kompetentë në ndërtimin e një koncepti të qartë të një strukture marketimi në turizëm ku vemannje të

## Objektivat e kursit

Në përfundim të kursit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të njojin format e marketimit në turizëm dhe nevojat e tregut, për ndërtimin paketave turistike dhe dukshmérinë e ofertës turistike
- Të mësojnë format e marketimit në botën globale, në ndërtimin e strategjive marketuese, media dhe neë media.
- Të realizojnë marketimin e një produksi konkret

veçantë do të këtë trashëgimia kulturore dhe mikpritja. Kursi do të kombinojë një panoramë të plotë mbi strukturat kombëtare mbështetëse në marketimin turistik dhe më pas do të punohet me konceptin e marketimit në praktikë. Si po zhvillohet sot industria e turizmit në botën globale? Çfarë kërkohet në ofertën turistike? Si do të duhet të konceptojmë mesazhin që duam të tejcojmë mbi ofertën tonë dhe cilat janë format e komunikimit masiv me atë segment të tregut për të cilët kemi realizuar produktin turistik. Format e reja të marketimit, risitë dhe potenciali turistik në Shqipëri dhe më në veçanti zonën e Shqipërisë juglindore, Pogradeci. Si të jemi të pranishëm në tregun lokal, kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

## Përbajtja tematike dhe aktivitetet

1. Hyrje në kurs: Cfarë është marketimi dhe cfarë është turizmi
  2. Potencialet turistike në vend dhe nevojat e tregut në turizëm
  3. Struktuarat administrative në ndihmë të marketimit turistik
  4. Cfarë ofrojmë ne ndryshe nga të tjera
  5. Kujt i drejtoshemi
  6. Si ta reklamojmë produktin turistik
  7. Media dhe neë media, ndërtimi i mesazhit dhe imazhit
  8. Realizim i një spoti publicitar, eeb, facebook, instagram
- Në përfundim të kursit pjesëmarrësit do të pajisen me modele të ndryshme në print dhe në trajtë elektronike.